




Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË KINE
10 MAJ 2026



FLUTURIMET

Fluturimi Shqiperi – Kinë 10 Maj 2026 (Austrian Airlines)

Tiranë (TIA) – Vienë (VIE) : 06:00 – 07:30

Vienë (VIE) – Shanghai (PVG) : 13:15 – 06:00 (11 Maj)

Fluturimi Kinë – Shqiperi 18 Maj 2026 (Lufthansa Airlines)

Pekin (PEK) – Mynih (MUC) : 13:25 – 19:15

Mynih (MUC) – Tiranë (TIA) : 21:45 – 23:30





ITINERARI

Dita 1: Tiranë – Shanghai

Udhëtim në Kinë nis duke u takuar me guidën rreth orës 03:00 në aeroport. Nisja nga Tirana International Airport bëhet në orën 06:00. Fluturojmë drejt Vienës, dhe mbërrimë aty në orën 07:30. Më pas fluturojmë për në Shanghai në orën 13:15.

Dita 2: Mbërritja dhe mikpritja në Shanghai

Mbërritja në aeroportin e **Shanghai** në orën 06:00. Më pas vijojmë me takimin e partnerëve tanë dhe nisemi për në Shanghai me trenin Transrapid, i cili arrin shpejtësi deri në 430 km/h. Pas zbritjes nga treni, marrim autobusin dhe drejtohem për në hotel ku do të lemë valixhet dhe do të vazhdojmë me një tur të Tempullit Jing'an, vetëm 15 minuta larg. Tempulli Jing'an është një tempull 780 vjeçar, i cili përmban një statujë madhështore të Budës prej bronzi dhe oborre të qeta ku dëgjohen vetëm tingujt e kambanave.

Pas vizitës në tempull do të kthehem në hotel për të bërë check-in dhe do të kemi kohë të lirë për tu shpłodhur derisa të vijë orari i darkës. Para se të konsumojmë darkën, do të kemi një vizitë në **rrugën e famshme Nanjing Road**, një nga zonat më të gjalla dhe më të njohura të qytetit, e mbushur me dyqane, drita dhe atmosferë moderne kineze.

Konsumojmë darkën në grup. Fjetja në **UrCove Shanghai Jing'an by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Darka



ITINERARI



Dita 3: Shanghai

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita nis me një vizitë në **Kopshtet Yuyuan**, një shembull i shkëlqyer i arkitekturës tradicionale të kopshteve kineze nga Dinastia Ming. Ecnë mes gjelbërimit, pavilioneve të hijshme dhe liqeneve plot lotus, ndërsa ndjeni qetësinë e këtij vendi magjik. Pranë kopshtit ndodhet **Pazari i Qytetit të Vjetër**, ku ngjyrat dhe gjallëria janë gjithkund. Ky Pazar është vendi ideal për të shijuar artizanatet tradicionale dhe ushqimet e shijshme të rrugës (street food).

Vazhdojmë vizitën me Tempullin e **Jade Buddha**, një oaz qetësie në qytet. Ky tempull ruan dy statuja madhështore të Budës, të skalitura me gurë të çmuar jade të bardhë. Dita përfundon me një shëtitje përgjatë **Bregut të Shanghait** (The Bund), ku ndërtesat koloniale historike bëjnë kontrast me qiellgërvishtëset futuristike të qytetit.

Në mbrëmje do të përjetojmë një eksperiencë magjike në lumin Huangpu. Një **shëtitje me krociere** përgjatë lumit do të na ofrojë pamje mahnitëse të Shangait natën — qiellgërvishtëset që ndriçojnë si kristale, ndërtesat historike të Bund-it që pasqyrohen në ujë dhe atmosfera elektrizuese e një qyteti që nuk fle kurrë. Një mënyrë perfekte për të mbyllur ditën mes dritave dhe hijeshisë së këtij metropoli modern.

Konsumojmë darkën në grup. Fjetja në **UrCove Shanghai Jing'an by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 4: Shanghai – Suzhou

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Udhëtojmë drejt **Suzhout** (100km ~ 1.5 orë), qytet i njohur për kopshtet elegante dhe degëzimet mahnitëse të ujit. Fillojmë vizitën me **Kopshtin e Mjeshtrit të Rrjetave** (Master of the Nets), një pasuri e trashëgimisë botërore të UNESCO-s që ofron një përjetim harmonik mes ujit dhe arkitekturës tradicionale.

Më pas vizitojmë një punishte mëndafshi, ku do të mësojmë për mjeshtërinë e prodhimit të mëndafshit, një art që ka karakterizuar Suzhoun për shekuj. Eksplorojmë **Portën Panmen**, një nga portat më të lashta të qytetit që simbolizon mbrojtjen e tij historike. Dita mbyllet me një shëtitje në rrugën piktoreske **Pingjiang**, të mbushur me çajtoje, kafene dhe dyqane artizanale.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në **UrCove Suzhou Shantang Street by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 5: Suzhou – Tongli – Xi'an

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Pas mëngjesit, nisemi nga Suzhou drejt qytetit të bukur ujqor, Tongli, i njohur për historinë e tij mbi 1,000-vjeçare dhe kanalet e tij të qeta. Eksplorojmë këtë qytet të lashtë duke lundruar nëpër rrugët e tij ujore, të rrethuara nga shtëpi tradicionale të bardha dhe ura të harkuara prej guri. Atmosfera e qetë sjell një shije të së kaluarës së lavdishme të Kinës.

Pas drekës, transferohemi për në Suzhou North Railway për të marrë trenin për në Xi'an (16:35 – 23:00).

Pas mbërritjes, transferohemi në hotel. Fjetja në **Mercure Xi'an Downtown Hotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI



Dita 6: Ushtria e Terrakotës dhe Tregjet e Xi'an-it

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, nisemi për në provincën e **Lingdong** (45km ~ 1 orë). Aty vizitojmë **Ushtrinë e Terrakotës**, një zbulim arkeologjik që përmban mijëra ushtarë, kuaj dhe qerre prej balte të ndërtuara për të ruajtur varrin e Perandorit të Parë të Kinës, Qin Shi Huang. Çdo figurë është unike në detaje, duke përfaqësuar fuqinë dhe pasurinë e kësaj dinastie.

Pas kësaj, do të vizitojmë një punishte tradicionale të gdhendjes së nefritit dhe do të mësojmë për mjeshtërinë e përpunimit të këtij guri të çmuar dhe do të bëjmë një shëtitje në tregun e vjetër të Xi'anit, të mbushur me suvenire dhe specialitete lokale.

Pas vizitave kulturore, dita vazhdon me një udhëtim drejt **Muslim Quarter**, zemra plot jetë e qytetit të lashtë. Rrugicat e ngushta janë të mbushura me aroma karamesh, erëza ekzotike dhe tregtarë që ofrojnë specialitete tradicionale kineze e ujqure. Një vend ku kultura, kuzhina dhe historia bashkohen në një mozaik të gjallë ngjyrash dhe tingujsh.

Mbrëmja rezervon një përvojë të paharrueshme: një **darkë tradicionale me dumplings kinezë**, të përgatitur sipas recetave autentike, e shoqëruar me **shfaqjen madhështore të Tang Dynasty Show** – një udhëtim artistik që ju çon pas në kohë, në epokën e artë të Kinës, përmes vallëzimeve, muzikës dhe kostumeve mbretërore.

Fjetja në **Mercure Xi'an Downtown Hotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 7: Xi'an – Pekin : Zbulimi i Qytetit të Ndalua

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, nisemi drejt Pekinit me tren të shpejtësisë së lartë (09:10 – 13:30). Pas mbërritjes do të pritemi nga guida jonë lokale dhe shoferi. Do të vizitojmë Pallatin e Verës (Summer Palace) – një nga mrekullitë më të bukura të Kinës, i njohur për liqenin e qetë Kunming, pavionet e hijshëm dhe kopshtet e gjelbëruara që dikur shërbenin si vend pushimi për perandorët. Një shëtitje mes urave tradicionale dhe tempujve elegantë na ofron një udhëtim në historinë e Dinastisë Qing.

Më pas, do të bëjmë një vizitë nga jashtë tek Stadiumi "Bird's Nest", simboli modern i Pekinit dhe një nga monumentet më të njohura të Lojërave Olimpikë. Struktura e tij unike, që ngjan me një fole zogu, përfaqëson kombinimin perfekt të arkitekturës bashkëkohore dhe shpirtit inovativ të qytetit. (Nëse na premton koha, stadiumin mund ta vizitojmë dhe nga brenda me kosto shtesë).

Konsumojmë darkën në grup. Fjetja në **Mercure Beijing City Centre**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI



Dita 8: Pekin – Muri i Madh Kinez dhe Pallati Veror

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Dita nis me një vizitë në **Sheshin Tian'anmen**, zemrën historike dhe politike të Pekinit. Ky është një nga sheshet më të mëdha në botë, i rrethuar nga monumente madhështore si Mauzoleumi i Mao Ce Dunit dhe Salla e Kuvendit Popullor. Teksa ecim në këtë shesh, mund të ndjejmë fuqinë dhe solemnitetin e historisë kineze që ndërthuret me ritmin modern të kryeqytetit, një moment i paharrueshëm për çdo vizitor që dëshiron të kuptojë shpirtin e Kinës.

Më pas do të vizitojmë **Qytetin e Ndaluar**, një kompleks perandorak që ka shërbyer si selia e perandorëve kinezë gjatë Dinastive Ming dhe Qing. Eksplorojmë oborret e tij të mëdha, sallat madhështore dhe arkitekturën e mrekullueshme që pasqyrojnë fuqinë dhe arritjet artistike të Kinës së lashtë.

Pas kësaj, nisemi drejt Murit të Madh Kinez në Juyong Pass, një nga pjesët më të ruajtura dhe mbresëlënëse të kësaj ndërtese ikonike. Aty do të shëtisim përgjatë rrugëve të tij të lashta dhe do të shijojmë pamjet panoramike të maleve të ashpra dhe luginave të gjelbra. Gjatë rrugës, vizitojmë dhe një punishte të perlave të freskëta, ku do të mësoni për kultivimin dhe mjeshtërinë e tyre, një pjesë e rëndësishme e kulturës kineze. Në mbrëmje, e mbyllim udhëtimin tonë me një darkë madhështore lamtumire duke shijuar rosën e Pekinit, një specialitet kulinar që përfaqëson kryeqytetin.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në **Mercure Beijing City Centre**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 9: Pekin – Tiranë

Bëjmë check-out herët në mëngjes dhe nisemi për në aeroport për tu kthyer në Tiranë.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi



DETAJET E SHËRBIMIT

Kategoria e Hoteleve: 4* & 5*

Numri i ditëve: 9

Numri i netëve: 7

Qytetet që vizitohen: 5: Shanghai, Suzhou, Tongli, Xi'an, Pekin

Monumentet që vizitohen: 21: Rruga Nanjing, Tempulli Jing'an, Kopshti Yuyuan, Tempulli i Budës prej Nefriti, The Bund, Lundrimi në Lumin Huangpu, Kopshti i Mjeshtrit të Rrjetave, Punishtja e Mëndafshit, Porta Panmen, Rruga Pingjiang, Qyteti i Lashtë i Ujit Tongli, Ushtria e Terrakotes, Punishtja e Gdhendjes së Nefritit, Lagjja Myslimane, Shfaqja e Dinastisë Tang, Pallati i Verës, Foleja e Zogjve (pamje nga jashtë), Sheshi Tian'anmen, Qyteti i Ndalar, Muri i Madh (Kalimi Juyong), Punishtja e Perlave

Aktivitetet e vizituara: 5: Shëtitje në qytet, Lundrim në Shanghai, Shfaqja e dinastisë Tang, Trena me shpejtësi të lartë, Ngjitje në Murin e Madh

Numri total i vakteve të përfshira: 18

HB në ditët: 5, 7

FB në ditët: 3, 4, 6, 8

KM: 540 km

Kohë totale transporti në rrugë tokësore: 11.5 orë

Distanca mesatare e përshkruar : 60 KM/Ditë

Koha mesatare e transportit : 1.5 orë/ditë

ELITE TRAVEL AGENCY


ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL



SHANGHAI – URCOVE SHANGHAI JING'AN BY HYATT 4*

(8.8 RATING NE BOOKING DHE 4.5 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



SUZHOU – URCOVE SUZHOU SHANTANG STREET BY HYATT 4*

(9.3 RATING NE TRIP DHE 5.0 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



XI'AN – MERCURE XI'AN DOWNTOWN HOTEL 4*

(8.8 RATING NE BOOKING DHE 4.7 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



BEIJING – MERCURE BEIJING CITY CENTRE 4*

(9.5 RATING NE TRIP)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperiencia autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktivitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkesë të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuar me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anulimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. [Klikoni këtu](#)

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL